

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data 29 / 09 / 2020]

Për: „SHKELQIMI 07“ shpk , Adresa: Belishove, Mallakaster

Procedura e prokurimit: Kerkese per propozim

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-68789-08-14-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rrethimi dhe ndriçimi i kaptazheve dhe rezervuarëve të furnizimit me ujë të pijshëm ,në administrimtë ujësjellës kanalizimeve sh.a”, me fond limit 7,450,761 leke (shtatëmilionë e katerqinde e pesedhjetëmijë e shtatqinde e gjashtedhjetë e nje) pa përfshirë vleftën e TVSH-së dhe kohezgjatje 60 dite nga lidhja e kontrates.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.59, date 24 Gusht 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|------------|
| 1.“BEQIRI” shpk | J98624801V |
| Vlera: 5,290,200 (pesemilione e dyqinde e nentedhjetemije e dyqinde) leke | |
| 2.“COGREN” shpk | J74818825K |
| Vlera: Ska paraqitur oferte | |
| 3.“COLOMBO” shpk | J82916489E |
| Vlera: 5,472,140 (pesemilione e katerqinde e shtatedhjetë e dymije e njeqinde e dyzete) leke | |
| 4.“MANE/S” shpk | J64103865K |
| Vlera: 5,676,400 (pesemilione e gjashteqinde e shtatedhjetë e gjashtemije e katerqinde) leke | |
| 5.“MENI” shpk | J61909018W |
| Vlera: 4,979.800 (katermilione e menteqinde e shtatedhjetë e nentemije e tetqinde) leke | |
| 6.“SHAMO CONSTRUCTION” shpk | L01326020F |
| Vlera: 6,839,200 (gjashtemilione e tetqinde e tridhjetë e nentemije e dyqinde) leke | |
| 7.“SHKELQIMI 07” shpk | K68121808W |
| Vlera: 6,800,500 (gjashtemilione e tetqindemije e pesqinde) leke | |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.“BEQIRI” shpk	J98624801V
2.“COGREN” shpk	J74818825K
3.“COLOMBO” shpk	J82916489E
4.“MANE/S” shpk	J64103865K
5.“MENI” shpk	J61909018W
6.“SHAMO CONSTRUCTION” shpk	L01326020F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I."BEQIRI" shpk

1.Operatori ekonomik nuk ka plotësuar te plote kriterin "**Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë ne listpagesat dhe ne licencen e shoqërisë për periudhën e kërkuar (dhe me kontratë pune të vlefshme të lidhur ne praninë e noterit, CV, diplome)"**

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Mjek 1 (nje)

Mjekja Merikjana Beqiraj me te cilin është lidhur kontrata e punës mes punëdhësit dhe punëmarresit Nr.747 Rep, date 20.06.2016, ku përcaktohet se kontrata është me kohë të plote dhe paga do të jetë 35,000 leke/muaj. Nga kësaj liste pagesave shihet se nuk është respektuar kontrata e punës pas i mmjekja figuron me kohë të pjeshme dhe page me të ulet se ajo e parshikuar në kontratë, për sa më poshtë

- Janar 2019 kater dite pune dhe page 5,000/muaj leke.
- Shkurt 2019, tete dite pune, paga 10,000/muaj leke.
- Mars 2019 - Nentor 2019, njezete e gjashte dite pune 26,000/muaj leke
- Dhjetor 2019 njezete e dy dite pune, paga 22,000/muaj leke
- Janar 2020 , tre dite pune, paga 4,000/muaj leke
- Shkurt 2019, tetembedhjete dite pune, paga 18,000/muaj leke
- Mars 2020 - Qershor 2020, dhjete dite pune , paga 10,000/muaj leke

Vendosja e kërkesave për kualifikim i shërben autoritetit për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës kur nga ana tjetër OE nuk garanton as zbatimin e një kontrate mes tij dhe punëmarresit, një shkelje kjo dhe përse i përket legjisllacionit të Kodit të Punës.

Veprimet e siperpermendura jane ne kundërshtim me VKM-ne nr.692,date 13.12.2001 "Per masat e veçanta te sigurise dhe mbrojtjes ne pune", ndryshuar me VKMnr742,date06.11.2003, pika 12.3

2.OE nuk ploteson kushtin per "**Per efekt te kryerjes se punimeve ne teresi ofetuesi duhet te kete një punësim mesatar me të paktën 25 (njetete e pese) personave, për periudhën Janar 2019 - Qershor 2020 se bashku me stafin**" Ku per kete kerkohet: 1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, per Janar 2019 - Qershor 2020. Listepagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2019 - Qershor 2020, te konfirmuara nga organet perkatese Ne listepagesat e paraqitura per periudhen Janar 2020-Qeshor 2020 jane me kohe te plote pune me pak se 25 punonjes duke mos plotesuar numrin e punonjesve te kerkuar. Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës, Kreu V, neni 12, specifikohet: Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënësi, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Ne kerkesat per kualifikim percaktohet kerkesa per 25 punonjes dhe shmangia apo deklarimi i pak diteve pune nuk provon kapacitetin teknik te kerkuar ne kerkesen e mesiperme. Persa me lart OE nuk ka plotesuar kriterin e mesiperme

3.Operatori ekonomik nuk ka plotesuar te plote kriterin ekonomik dhe financiar **vertetim per shlyerjen e taksave vendore prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKB-se**, e konkretisht:

Per objektet e paraqitura si pune te ngjashme "Ndertim fusha sportive prane stadiumit" me investitor Bashkia Durres te cilin operatori ekonomik e ka realizuar per periudhen 20.11.2017 - 12.02.2018, sipas Formularit te Vleresimit (Shtojca 8) e paraqitur nga vet operatori ekonomik ,si dhe objektin "Riparim , mirembajtje ujesjellsa ne Bashkine Selenice" me investitor Bashkia Selenice te cilin operatori ekonomik e ka realizuar per periudhen 24.11.2017 - 08.06.2018, sipas Formularit te Vleresimit (Shtojca 8), nuk figurojne ne Ekstraktin e QKB-se.Referuar ligjit Nr. 8/2015 Neni 2 pika 16: "Veprimtari eshte veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar ne menyre te vazhdueshme nga subjektet. Gjithashtu referuar ligjit 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, "Per procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet: "Ne perputhje me ligjin per regjistrimin e biznesit, aplikimi per ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia ne cdo rast behet perpara nisjes efektive te veprimtarise ne ate vend. Per hapjen e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me nje certifikate me numer unik identifikimi te njejte me ate te regjistrimit, por me numer serial te ndryshem. Kjo certifikate leshohet per te identifikuar vendodhjen e ushtrimit te veprimtarise, kur eshte e ndryshme nga selia. Per kete rast OE duhet te ishte paisur me certifikate dhe te regjistrohej ne QKB e per pasoje i eshte shmangur detyrimeve tatimore

vendore perkatese. Persa me lart OE nuk e ka plotesuar detyrimin per shlyerjen e taksave vendore .

II. "COGREN" shpk , ska paraqitur oferte

Operatori ekonomik perveç licences se shoqerise, si dhe vertetimit te xhiros per tre vitet e fundit nuk ka paraqitur asnje dokument tjeter. Po ashtu operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferte

III. "COLOMBO" shpk

1.Operatori ekonomik nuk ka plotesuar te plote kriterin **"Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë ne listpagesat dhe ne licencen e shoqerise per periudhen e kerkuar (dhe me kontratë pune të vlefshme te lidhur ne pranine e noterit, CV, diplome)"**

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Mjek 1 (nje)

Mjeku Lefter Kulluri me te cilin eshte lidhur kontrata e punes mes punedhenesit dhe punemarresit Nr.2059 Rep, date 29.06.2017, ku percaktohet se kontrata eshte me kohe te plote dhe paga do te jete 33,000 leke/muaj. Nga kqyrja e liste pagesave shihet se nuk eshte respektuar kontrata e punes pas i mjeku figuron me kohe te pjeshme dhe page me te ulet se ajo e parshikuar ne kontrate, per sa me poshte

- Janar 2019,Mars 2019,Prill 2019 trembedhjete dite pune dhe page 15,364/muaj leke.
- Shkurt 2019, njembedhjete dite pune, paga 13,000/muaj leke.
- Maj 2019, dhjete dite pune 11,818/muaj leke
- Qershor 2019 - Dhjetor 2019 trembedhjete dite pune, paga 19,500/muaj leke
- Janar 2020 , njembedhjete dite pune, paga 13,000/muaj leke
- Shkurt 2020,Mars 2020,Qershor 2020 dymbedhjete dite pune, paga 14,181/muaj leke
- Prill 2020 , pese dite pune , paga 7,500/muaj leke
- Maj 2020, dhjete dite pune , paga 11,818/muaj leke

Vendosja e kerkesave per kualifikim i sherben autoritetit per te garantuar zbatimin me sukses te kontrates kur nga ana tjere OE nuk garanton as zbatimin e nje kontrate mes tij dhe punemarresit, nje shkelje kjo dhe persa i perket legjislacionit te Kodit te Punes.

Veprimet e siperpermendura jane ne kundersiztim me VKM-ne nr.692,date 13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurise dhe mbrojtjes ne pune", ndryshuar me VKMnr742,date06.11.2003, pika 12.3

2.Operatori ekonomik nuk ka plotesuar kriterin per të provuar përvojë mëparshme, ku autoriteti kontraktor kërkon: **a)Pune te ngjashme per nje objekt te vetem me vlere jo me te vogel se 50% te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet, te realizuar gjate gjatë tri viteve të fundit ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është ne nje vlere jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Puna e ngjashme e paraqitur me objekt "Rikonstruksion i poliklinikes se specialiteteve" si dhe "Rikonstruksioni i rrugeve te fshatit Shirt-Pezhelme" , nuk perkojne plotesisht me objektin qe prokurohet pasi ne to nuk ka punime per rrethim objektesh qe zene rreth 80% te vleres se objektit.

IV."MANE/S" shpk

1.Operatori ekonomik nuk ka plotesuar te plote kriterin ekonomik dhe financiar **vertetim per shlyerjen e taksave vendore prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKB-se,** e konkretisht:

Per objektet e paraqitura si pune te ngjashme "Ndertim i ujsjellsave Navarice-Memoraq-Dermish" me investitor Bashkia Finiq te cilin operatori ekonomik e ka realizuar per periudhen 19.01.2017 - 28.12.2018, sipas Formularit te Vleresimit (Shtojca 8) e paraqitur nga vet operatori ekonomik ,si dhe objektin "Restaurim shtepia e vellezerve Frasheri" me investitor Instituti i Monumenteve te Kultures Tirane te cilin operatori ekonomik e ka realizuar per periudhen 11.06.2018 - 08.08.2018, sipas Formularit te Vleresimit (Shtojca 8), nuk figurojne ne Ekstraktin e QKB-se.Referuar ligjit Nr. 8/2015 Nenit 2 pika 16: “Veprimtari eshte veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar ne menyre te vazhdueshme nga subjektet. Gjithashtu referuar ligjit 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, “Per procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet: “Ne perputhje me ligjin per regjistrimin e biznesit, aplikimi per ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia ne cdo rast behet perpara nisjes efektive te veprimtarise ne ate vend. Per hapjen e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me nje certifikate me numer unik identifikimi te njejte me ate te regjistrimit, por me numer serial te ndryshem. Kjo certifikate leshohet per te identifikuar vendodhjen e ushtrimit te veprimtarise, kur eshte e ndryshme nga selia. Per kete rast OE duhet te ishte paisur me certifikate dhe te regjistrohej ne QKB e per pasoje i eshte shmangur detyrimeve tatimore vendore perkatese. Persa me lart OE nuk e ka plotesuar detyrimin per shlyerjen e taksave vendore .

Nga ana e operatorit ekonomik eshte paraqitur vertetim per likudimin e taksave vendore vetem nga Bashkia Sarande , ky ky operator ka zyrat qendrore sipas ekstraktit te QKB-se.

2. Operatori ekonomik nuk ka plotesuar te plote kriterin **"Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë ne listpagesat dhe ne licencen e shoqerise per periudhen e kerkuar (dhe me kontratë pune të vlefshme te lidhur ne pranine e noterit, CV, diplome)"**

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik 1 (nje)

- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Mjek 1 (nje)

Dokumentacionin shoqerues i kontratave per drejtuesit teknik Aida Mahmutaj, Inxhiniere Mjedisi, Mitro Druri Inxhinier Elektrik dhe Roland Trungu Inxhinier Hidroteknik jane fotokopje te cilave u mungon vertetimi noterial i njehsimit me origjinalin, ne kundershtim me kerkesat sipas DST-se, ne te cilen theksohet se *Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*".

V. "MENI" shpk

1. Operatori ekonomik nuk ka plotesuar kriterin per të provuar përvojë mëparshme, ku autoriteti kontraktor kërkon: **a) Pune te ngjashme per nje objekt te vetem me vlere jo me te vogel se 50% te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet, te realizuar gjate gjatë tri viteve të fundit ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është ne nje vlere jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Ne objektin e paraqitur "Rikonstruksion i plote i shkolles "Oso Kuka" me investitor Bashkia Shkoder te cilin operatori ekonomik e ka realizuar per periudhen 05.05.2017 - 04.08.2017 konstatohen mangesite e meposhtme:

Objekti eshte jashte afatit 3 vjecar te percaktuar ne kerkesat per kualifikim dhe ne LPP. Sipas Formularit te Vleresimit (Shtojca 8) e paraqitur nga vet operatori ekonomik kontra ka filluar me date 05.05.2017 dhe ka perfunduar me 04.08.2017

Gjithashtu puna e ngjashme e paraqitur, nuk perkon plotesisht me objektin qe prokurohet pasi ne te nuk ka punime per rrethim objektesh qe ze rreth 80% te vleres se objektit , si dhe nuk ka punime per sinjalistiken rrugore.

2. Operatori ekonomik nuk ka plotesuar te plote kriterin ekonomik dhe financiar **vertetim per shlyerjen e taksave vendore prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKB-se**, e konkretisht

Per objektin "Rikonstruksion i plote i shkolles "Oso Kuka" me investitor Bashkia Shkoder te cilin operatori ekonomik e ka realizuar per periudhen 05.05.2017 - 04.08.2017, sipas Formularit te Vleresimit (Shtojca 8) e paraqitur nga vet operatori ekonomik , nuk figuron ne Ekstraktin e QKB-se.Referuar ligjit Nr. 8/2015 Nenit 2 pika 16: "Veprimtari eshte veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar ne menyre te vazhdueshme nga subjektet. Gjithashtu referuar ligjit 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, "Per procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet: "Ne perputhje me ligjin per regjistrimin e biznesit, aplikimi per ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia ne cdo rast behet perpara nisjes efektive te veprimtarise ne ate vend. Per hapjen e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me nje certifikate me numer unik

identifikimi te njejte me ate te regjistrimit, por me numer serial te ndryshem. Kjo certifikate leshohet per te identifikuar vendodhjen e ushtrimit te veprimtarise, kur eshte e ndryshme nga selia. Per kete rast OE duhet te ishte paisur me certifikate dhe te regjistrohej ne QKB e per pasoje i eshte shmangur detyrimeve tatimore vendore perkatese. Persa me lart OE nuk e ka plotesuar detyrimin per shlyerjen e taksave vendore .

3. OE nuk ploteson kushtin per **"Per efekt te kryerjes se punimeve ne teresi ofetuesi duhet te kete një punësim mesatar me të paktën 25 (njetete e pese) personave, për periudhën Janar 2019 - Qershor 2020 se bashku me stafin"** Ku per kete kerkohet: 1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, per Janar 2019 - Qershor 2020. Listepagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2019 - Qershor 2020, te konfirmuara nga organet perkatese Ne listepagesat e paraqitura pak punonjes jane me kohe te plote pune duke mos plotesuar numrin e punonjesve te kerkuar. Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës, Kreu V, neni 12, specifikohet: Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Ne kerkesat per kualifikim percaktohet kerkesa per 25 punonjes dhe shmangia apo deklarimi i pak diteve pune nuk provon kapacitetin teknik te kerkuar ne kerkesen e mesiperme. Persa me lart OE nuk ka plotesuar kriterin e mesiperme

4.Operatori ekonomik nuk ka plotesuar te plote kriterin **"Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë ne listpagesat dhe ne licencen e shoqerise per periudhen e kerkuar (dhe me kontratë pune të vlefshme te lidhur ne pranine e noterit, CV, diplome)"**

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Mjek 1 (nje)

Mjekja Juela Agastra me te cilin eshte lidhur kontrata e punes mes punedhenesit dhe punemarresit me date 01.06.2020, ku percaktohet se kontrata eshte me kohe te plote dhe paga do te jete 26,000 leke/muaj ndersa ne liste pagesat e paraqitur ajo nuk figuron me kohe te plote (Muaji Qershor nje dite pune dhe page 1182/muaj leke.

Mjekja Marsida Buci (Çollaku) me te cilin eshte lidhur kontrata e punes mes punedhenesit dhe punemarresit me date 01.09.2017, ku percaktohet se kontrata eshte me kohe te plote dhe paga do te jete 24,000-26,000 leke/muaj ndersa ne liste pagesat e paraqitur ajo nuk figuron me kohe te plote (Periudha Janar 2019 - Maj 2020, nje dite pune ne muaj dhe page 1182 leke dhe page 1182 lek/muaj).

Vendosja e kërkesave për kualifikim i shërben autoritetit për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës kur nga ana tjetër OE nuk garanton as zbatimin e një kontrate mes tij dhe punëmarresit, një shkëlqje kjo dhe përse i përket legjislacionit të Kodit të Punes.

Veprimet e sipërpermendura janë në kundërshtim me VKM-ne nr.692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurisë dhe mbrojtjes në punë", ndryshuar me VKMnr742, datë 06.11.2003, pika 12.3

5. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar të plotë kriterin "**Disponimi i mjeteve dhe paisjeve**" pasi :

Autobetonierja e paraqitur është kantieri i shoqëruar vetëm me dokumenta blerjeje dhe jo siç kërkohet në DST një automjet i cili shënohet në regjistrat publike i shoqëruar me leje qarkullimi, certifikate të kontrollit teknik, siguracion, dhe foto të tij, që do të kryejë transportin e betonit prej linjes së prodhimit ,për në objektin e prokurimit

VI. "SHAMO CONSTRUCTION" shpk

1.Operatori ekonomik nuk ka plotësuar të plotë kriterin "**Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë në listpagesat dhe në licencën e shoqërisë për periudhën e kërkuar (dhe me kontratë pune të vlefshme të lidhur në praninë e noterit, CV, diplome)**"

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Mjek 1 (nje)

Me Mjekun Eduart është lidhur kontrata e punës mes punëdhënesit dhe punëmarresit me datë 12.11.2016 e lidhur jo në praninë e noterit, ku përcaktohet se paga do të jetë 22,000 leke/muaj (jo me pak se paga minimale në shkallë vendi). Nga kësaj liste pagesave shihet se nuk është respektuar kontrata e punës pas mjeku nuk figuron në disa muaj si Janar, Shkurt, Prill, Maj të vitit 2020, po ashtu edhe për muajt Qershor 2019-Dhjetor 2019, ndërsa në muajt e tjerë figuron me page me të ulet se ajo e parshikuar në kontratë.

Vendosja e kërkesave për kualifikim i shërben autoritetit për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës kur nga ana tjetër OE nuk garanton as zbatimin e një kontrate mes tij dhe punëmarresit, një shkëlqje kjo dhe përse i përket legjislacionit të Kodit të Punes.

Veprimet e sipërpermendura janë në kundërshtim me VKM-ne nr.692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurisë dhe mbrojtjes në punë", ndryshuar me VKMnr742, datë 06.11.2003, pika 12.3

2.Operatori ekonomik nuk ka plotesuar kriterin "**Drejtuesi/t teknik i/te shoqerise nuk duhet te jete/ne te punesuar ne asnje subjekt tjeter shteteror. Drejtuesi/t teknik i/te shoqerise nuk duhet te jete/ne te punesuar ne asnje subjekt tjeter privat ne rolin e drejtuesit teknik. Per kete shoqeria duhet te paraqese nje deklarate nga Administratori i saj dhe te deklaroje se autorizon Autoritetin Kontraktor per verifikimin e informacionit te dhene.Mosparaqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim"**, pasi nuk ka paraqitur deklaraten lidhur me kete pike.

3.Operatori ekonomik nuk ka plotesuar te plote kriterin "**Disponimi i mjeteve dhe paisjeve"** pasi :

Autovinçit me targa AA957JB, i mungon leja e qarkullimit, ne kundershtrim me percaktimet e bera ne kete kriter ku citohet "*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit, policen e sigurimit të mjetit dhe foto të mjetit ku të jete e dukshme targa e mjetit*"

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik „SHKELQIMI 07“ shpk , Adresa: Belishove,Mallakaster se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6,800,500 (gjashtëmilione e tetqindemije e pesqinde) leke është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Sh.A Ujesjelles Kanalizimeve Delvine,Lagjia “Sinan Ballaci”,Rruga “Nazif Haderi”,Delvine ,Zyra Juridike, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21 / 09 / 2020

Ankesa: JO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Vasil MARGA